



REPUBLIKA E KOSOVËS



KOMUNA HANI I ELEZIT

Nr. i Prot: 08/5077

Data: 09.07.2025

DREJTORIA PËR ZHVILLIM EKONOMIK DHE TURIZËM
RAPORTI I PUNËS PËR GJASHTËMUJORIN E PARË TË VITIT 2025

Hani i Elezit
Korrik, 2025

Gjatë periudhës Janar-qershor të vitit kalendarik 2025, Drejtoria për Zhvillim Ekonomik dhe Turizëm ka marrë pjesë në të gjitha takimet, konferencat dhe punëtoritë që i përkasin sferës së zhvillimit ekonomik dhe atij turistik me interes për Komunën e Hanit të Elezit. Disa aktivitete të tjera kanë përfshirë:

- Nënshkrimi i marrëveshjes me Agjencioin për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale me Komunën e Hanit të Elezit për hartimin e projektit të fazës së tretë “Ekzodi I Bllacës 99” ku parashihet kthimi i trenit në muze dhe hapësirë ekspozuese.
- Është bërë shpërndarja e kartolinave dhe luleve për festën e 8 marsit, tashmë traditë e drejtorisë për bizneset locale.
- Janë subvencionuar bizneset fillestare dhe ato start-up përmes Thirrjes Publike të vitit 2025, ku vlera e financimit nga ana e komunës arrinë shifrën prej 17,172.60 euro.
- Ka filluar implementimi i projektit capital “Ballkoni Panormaik tek shkronjat e UÇK-së vlera e të cilit arrinë shumës prej 48,000.00 euro si financim i plotë nga komuna.
- Kemi bashkëpunuar me KLGI-në dhe komunën e Çairit nga Maqedonia për aplikim në fondet e thirrjes së re në IPA.
- Kemi nënshkruar Marrëveshje bashkëpunimi me organizatën Kosova Eëomen for Eëomen ku parashihen aktivitete për fuqizimin ekonomik lokal.
- Është implementuar projekti i “Rregullimit të Këndit të Lodrave në Qendër të Qytetit” si financim nga KFOR-i Italian.
- Është nënshkruar marrëveshje e bashkëpunimit me Universitetin për Biznes dhe Teknologji për ndërlidhjen e ekspertizës akademike me vizionin strategjik të komunës.
- Është nënshkruar marrëveshje për bashkëfinancim të implementiit të projektit “Rregullimi i hapësirave turistike në Han të Elezit dhe në fshatrat: Pustenik, Krivenik, Seçishtë, Paldenicë, Gorancë” ku do të implementohet projekti për rregullimin e hapësirës turistike në zonën kadastrale Gorancë-Rezhancë vlera e të cilit arrinë shifrën rreth 100,000.00 euro.

SEKTORI I TAKSAVE PËR USHTRIM TË VEPRIMTARISË

Inspektimet Janar-Qershor 2025	20
Gjobat	0
Aktvendimet dhe shpërndarja e tyre tek subjektet aktive	220
Faturat e lëshuara gjatë viti 2025	50
Faturimi për vitin 2025	95,662.68
Inkasimi për vitin 2025	73,299.00

Përshkrimi	Periudha Kohore	Viti 2025	Viti 2024
TAKSË PËR USHTRIM TË VEPRIMTARISË	Janar-Qershor	73,299.00 €	73,702.88 €

QENDRA PËR REGJISTRIM TË BIZNESEVE

○ APLIKIME PËR BIZNESE TË REJA

Përshkrimi	Lloji	Numri	Totali 2025	Gjinia
Regjistrim biznesi	Biznese individuale / B.I	13	13 B.I	07 / F
Regjistrim biznesi	Biznese Shoqëri me përgjegjësi të kufizuara / SH.P.K	12	12 Sh.P.K	18 / M

○ APLIKIME PËR SHUARJE TË BIZNESEVE

Përshkrimi	Lloji	Numri	Totali 2025	Gjinia
Shuarje të bizneseve	Biznese individuale / B.I	3	3 B.I	0 F
Shuarje të bizneseve	Biznese Shoqëri me përgjegjësi të kufizuara / SH.P.K	0	0 SH.P.K	3 M

○ APLIKIME PËR NDRYSHIME NË BIZNES

Përshkrimi i shërbimit	Totali
Kërkesë për informata	26
Kërkesë për ndryshimin e pronarëve /aksionarëve	1
Kërkesë për shtimin apo heqjen e aktivitetit	2
Kërkesë për ndryshim të adresës	3
Kërkesë për ndryshimin e drejtorit apo përfaqësuesit të autorizuar	1
Kërkesë për ndryshim të emrit tregtarë	1
Kërkesë për ndryshim të bordit	0
Kërkesë për shuarje të njësisë	1
Kërkesë për certifikatë dublikat	4

Majlinda Kaloshi
Drejtoreshë për Zhvillim Ekonomik dhe Turizëm